



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

TV Dukagjini
Riza Lluka
Drejtor
Pejë

Ankesa Nr. 2011/04-KPM vs TV Dukagjini
Ref:1210/864/KPM/as

VENDIM

Lidhur me Ankesë nr. 2011/04-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër TV Dukagjini ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) më datë 28 gusht 2009, ka vendosur që subjektin transmetues TV Dukagjini- Palë Përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të operuar si televizion lokal në Komunën e Pejës.
2. KPM me 7 maj 2009, ka nxjerrë Rregulloren për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore (CIMC-2009/01). Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional e social të fëmijëve dhe të miturve.
3. Po ashtu në të njëjtën kohë Pala Përgjegjëse ka nënshkruar Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, për të vepruar si televizion lokal. Më marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi edhe Rregulloren për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore (CIMC-2009/01).
4. KPM ka bërë monitorimin e Pala Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren CIMC-2009/01. KPM me datën 21 deri më 23 janar 2011, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC-2009/01.
5. KPM në bazë të Raportit të Monitorimit të datës 1 shkurt 2011, ka vërejtur se Pala Përgjegjëse prej datës 21 deri më 23 janar 2011 ka transmetuar seralin "El rostro de Amelia" pa e shoqëruar me shenjë përkatëse dhe pa paralajmërim akustik apo tekstual për përmbajtje të programit, në kundërshtim me nenin 7.2 dhe nenin 7.4 të Rregullores

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

CIMC-2009/01. Gjithashtu është vërejtur se disa nga filmat e kategorizuar si të kategorisë së tretë (+14) si filmat “The Echo” dhe “Honey Baby” janë transmetuar para kohës së përcaktuar, përkatësisht në kundërshtim me nenin 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01.

6. KPM, bazuar në shkeljen e nenit 6.2.3, 7.2 dhe 7.4 të Rregullores CIMC-2009/01, nga ana e Palës Përgjegjëse, më datën 2 shkurt 2011, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Përgjegjëse është kërkuar që të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
7. KPM edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datat 11, 12 e 13 mars 2011, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren CIMC-2009/01. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 2 shkurt 2011, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01. Me datë 11 dhe 12 mars 2011, filmat e kategorizuar si të kategorisë së dytë (10 +), si: “The Devil Ears parada”, “Camp rock 2 – The Final Jam”, “Suburban Girl” dhe “The budget List”, janë transmetuar para kohës së përcaktuar sipas Rregullores CIMC-2009/01, po ashtu edhe filmat e kategorisë së tretë (14 +) si: “El rostro de Amelia” dhe “Salt”, janë transmetuar para kohës së përcaktuar me Rregulloren CIMC-2009/01. Në të dy rastet Pala Përgjegjëse ka bërë vendosjen e piktogrameve në kundërshtim me kohën e paraparë me nenin 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01.
8. KPM, bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores CIMC-2009/01, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 16 mars 2011, i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01. KPM me anë të Vërejtjes ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren CIMC-2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
9. KPM, edhe pas Vërejtjes së dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse, prej datës 25 deri më 27 mars ku ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veproj në kundërshtim Rregulloren CIMC-2009/01, duke transmetuar filmat dhe serialet e kategorisë së dytë (10 +) dhe kategorisë së tretë (+ 14), para kohës së përcaktuar për këto kategori me Rregulloren CIMC-2009/01. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veproj në pajtim me nenin 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01.
10. KPM, ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme nga ana e Palës Përgjegjëse, më datën 1 prill 2011, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Urdhër përmes të cilit Pala Përgjegjëse urdhërohet të veprojë në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren CIMC 2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse. Me këtë Urdhër, Palës Përgjegjëse ju dha edhe një mundësi për të vepruar në pajtim me Rregulloren CIMC 2009/01.
11. KPM serish me datën 14 korrik 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Urdhrit të datës 1 prill 2011, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01. Në programin e transmetuar me datë 1 dhe 4 korrik 2011, Pala Përgjegjëse ka transmetuar filmat dhe serialet e kategorisë

së dytë (10 +) dhe ata të kategorisë së tretë (+ 14), para kohës së përcaktuar për këto kategori me Rregulloren CIMC-2009/01, duke vepruar vazhdimisht në kundërshtim me nenin 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01.

12. KPM gjithashtu edhe me datën 7 shtator 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse ku ka gjetur se ky subjekt vazhdon të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01.

Analiza Ligjore

13. Komisioni bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6.2.2, 6.2, 7.2 dhe 7.3 të Rregullores për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC-2009/01.

Neni 6.2.2 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 17:00 deri në orën 06:00”.

Neni 6.2.3 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së tretë mund të bëhet prej orës 23:00 deri në orën 06:00”.

Neni 7.2 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Shenjat e vërejtjes për Kategoritë e përcaktuara me nenin 7 janë të detyrueshme për të gjitha programet e përcaktuara në nenin 6”.

Neni 7.4 i Rregullores CIMC-2009/01 përcakton:

“Para fillimit të programit në TV shfaqet shenja e programit, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën ¼ e pjesë së dukshme të ekranit”.

14. KPM më datë 2 shkurt 2011 përmes Njoftimit për Shkelje ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
15. KPM, më datën 16 mars 2011, i ka dërguar Vërejtje Palës Përgjegjëse për shkelje të nenit 6.2.2 dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01, me anë të cilës ka kërkuar nga Palës Përgjegjëse që të veproj në pajtueshmëri të plotë me këtë Rregullore. Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të Vërejtjes ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01, duke transmetuar programe jashtë kohës së përcaktuar me Rregullore dhe duke bërë vendosjen e shenjave në kundërshtim me kohen e përcaktuar me Rregulloren CIMC 2009/01.
16. KPM, më datën 1 prill 2011, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Urdhër me të cilin urdhëron Palën Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren CIMC 2009/01.

17. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të Urdhrit, me të cilën është urdhëruar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC-2009/01, ka vazhduar të transmetoj programe të kategorisë së dytë para orës 17,00 dhe ato të kategorisë së tretë para orës 23,00 dhe duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 6.2.2. dhe 6.2.3 të Rregullores CIMC-2009/01.
18. Komisioni ka konstatuar se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të kësaj Rregullore, prandaj Komisioni si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshëm edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01.
19. Komisioni i KPM-së bazohet në Udhëzimin për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të licencuarve i cili përveç tjerave thotë se KPM gjithmonë e ka parasysh natyrën proporcionale të sanksioneve. Sanksionet do të jenë proporcionale me natyrën dhe me seriozitetin e një shkeljeje dhe me shkallen ekonomike të të licencuarit, dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.
20. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6.2.2, 6.2.3, 7.2, dhe 7.4, të Rregullores për Subjektet Transmetuese për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC-2009/01.

VENDIM


21. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 6.2.2, 6.2.3, 7.2 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01 pasi që ka transmetuar programe me përmbajtje të dëmshme programore jashtë kohës se lejuar me Rregulloren CIMC-2009/01, si dhe ka dështuar të bëjë paralajmërimin paraprak me sinjal akustik apo verbal gjatë transmetimit të programeve me përmbajtje të dëmshme programore.
22. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptohet masa sanksionuese **Vërejtje** për shkeljen e neneve 6.2.2, 6.2.3, 7.2 dhe 7.4 të Rregullores CIMC 2009/01.
23. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Rregulloren CIMC-2009/01 apo aktet tjera nënligjore të KPM-së, Komisioni do të iniciojë procedura ligjore për ndërmarrjen e masave tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me Nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
24. Komisioni gjithashtu kërkon nga ana e Palës Përgjegjëse që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet të cilat bien ndesh me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

E drejta për Ankesë

25. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
26. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
27. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



04. tetor 2012
datë